

RAPORT

**Partnerët potencialë lokalë dhe kombëtarë të angazhuar në
aktivitetet e biznesit të MAPs në nivel lokal, kombëtar dhe
ndërkombëtar, interesi i tyre për bimët e Dibrës.**

JANAR 2023

Ky raport është publikuar nga organizata World Vision Albania në kuadër të projektit “Përmirësimi i jetesës përmes ruajtjes së biodiversitetit të parkut natyror Korab Koritnik”, financuar nga Prespa Ohrid Nature Trust – PONT.

Raporti është hartuar nga:

- Prof. Dr. Alban Ibraliu
- Dr. Zyber Gjoni

Grupi teknik mbështetës:

- Majlinda Hoxha, Këshilltare Teknike, World Vision Albania
- Erblin Burnazi, Manaxher Projekti, World Vision Albania

Raporti mund të përdoret lirisht nga grupet e interesit.

Në çdo rast, shumëfishimi ose ripublikimi i këtij raporti duhet të shoqërohet me autorizimin e World Vision Albania dhe PONT.

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	4
2. POTENCIALET NATYRORE DHE PERSPEKTIVA E PËRDORIMIT TË QËNDRUESHËM TË BIMËVE MJEKËSORE DHE AROMATIKE NË SHQIPËRI	5
3. AKTORET E ZINXHIRIT TE VLERES SE MAPS NE SHQIPERI	8
3.1 KULTIVUESIT DHE MBLEDHËSIT	8
3.1.1 Mbledhësit e bimëve mjekësore dhe aromatike	8
3.1.2 Kultivuesit e bimëve mjekësore dhe aromatike	9
3.2. PRODUKTET KRYESORE TE BIEMVE AROMATIKE DHE MJEKESORE	10

1. Hyrje

Qëllimi kryesor i këtij studimi është nxitja e fermerëve të qarkut Dibër në kultivimin e bimëve aromatike dhe mjekësore, i cili vlerësohet si një sektor që gjeneron të ardhura të qëndrueshme ekonomike për fermerët. Ky studim synon të: (i) identifikojë aktorët kryesorë të përfshirë në zinxhirin e vlerës së bimëve aromatike dhe mjekësore në qarkun e Dibrës dhe në nivel kombëtar, (ii) të identifikojë pesë BMA që mund të kultivohen në zonën e Dibrës dhe për të cilat ka kërkesë të lartë në tregjet e eksportit si dhe (iii) të identifikohen pesë zona ku mund të kultivohen bimët aromatike dhe mjekësore.

Zinxhiri i vlerave të MAPs, është një nga sektorët më të rëndësishëm të sektorit të bujqësisë në Shqipëri. Shqipëria ka një traditë të konsoliduar në prodhimin dhe eksportin e MAPs. Më shumë se 95% e totalit të MAPs që mbledhen dhe kultivohen në vend eksportohen, duke e bërë Shqipërinë një lojtar të rëndësishëm ndërkombëtar në këtë sektor. Rritja e eksportit është shkaktuar nga një kombinim i ofertës në rritje (kryesisht nëpërmjet rritjes së MAPs të kultivuara) dhe rritjes së kërkesës së tregut botëror. Nga ana tjetër, rritja e eksporteve dhe oferta në rritje shoqërohet me disa sfida që lidhen me organizimin dhe koordinimin ndërmjet aktorëve. Shpesh, grupet e prodhuesve përballen me vështirësi dhe një akses të pasigurt në treg për shkak të marrëdhënieve të paqëndrueshme dhe jo bashkëpunuese ndërmjet fermerëve dhe konsoliduesve/përpunuesve apo tregtarëve me shumicë vendas. Mbledhësve, prodhuesve, konsoliduesve dhe eksportuesve gjithashtu u mungojnë njohuritë mbi kërkesat që lidhen me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë, si dhe mbi praktikën e mira bujqësore dhe konsideratat tjera agro-mjedisore.

Si rezultat, një kompleksitet i tillë dhe shumëllojshmëria e aktorëve të përfshirë kërkon një kuptim më të mirë të roleve dhe pozicioneve që mund të luajë dhe të zërë secili aktor në zinxhirin e vlerave të MAPs.

2. Potencialet natyrore dhe perspektiva e përdorimit të qëndrueshëm të bimëve mjekësore dhe aromatike në Shqipëri

Kërkesa për bimë mjekësore dhe aromatike është rritur globalisht për shkak të ndryshimeve në teknologji, të stilit të jetës dhe të kërkesave të konsumatorëve.

Duke përdorur klasifikimin e tregut të këtyre produkteve, ai mund të kategorizohet në katër tregje kryesore: a) farmaceutike, b) kozmetike, c) vajra esenciale dhe d) industria ushqimore. Kërkesa për bimë mjekësore dhe për erëza në industrinë ushqimore ka përjetuar prirje të lehtë rritëse në vitet e fundit. Evropa, në përgjithësi, dhe Gjermania, konsiderohet të jenë tregu më i rëndësishëm për produktet shqiptare.

Sektori i bimëve mjekësore dhe aromatike është shumë i rëndësishëm për ekonominë e Shqipërisë. Ka traditë të gjatë në mbledhjen e bimëve mjekësore dhe aromatike spontane, që filloi gjatë sistemit të ekonomisë së centralizuar, kur Shqipëria po eksportonte bimë mjekësore dhe aromatike me vlerën prej rreth 70 milion USD.

Bimët mjekësore dhe aromatike gjenerojnë më shumë se 30 milion Euro në vit dhe përfshin rreth 20 % të eksporteve të përgjithshme bujqësore. Edhe në nivelin e mikro-ekonomisë, bimët mjekësore dhe aromatike kontribuojnë në pjesë të madhe të të ardhurave të një familjeje, kryesisht si aktivitet me kohë të pjesshme, veprimtari me të cilën merren më shumë se 100.000 banorë ruralë. Sektori ka qenë burim i rëndësishëm i të ardhurave të ekonomisë së planifikuar.

Shqipëria ka traditë të hershme në prodhimin dhe në eksportimin e Bimëve Mjekësore dhe Aromatike. Bimët mjekësore dhe aromatike kanë qenë dhe mbeten produktet kryesore të ushqimit për qëllime eksporti, aktualisht duke qenë i dyti më i rëndësishëm pas perimeve. Më shumë se 95 % e bimëve mjekësore dhe aromatike të përgjithshme të mbledhura eksportohen. Shqipëria është lojtar ndërkombëtar i renditur si ndër eksportuesit më të mirë, i 16^{ti} në shkallë botërore të bimëve mjekësore dhe aromatike në fillim të vitit 2016. (UNSTAT Comtrade, 2019, EUROSTAT, 2020)

Më shumë se 50 % e bimëve mjekësore dhe aromatike shqiptare eksportohen në BE, duke synuar Gjermaninë, ndjekur nga Franca dhe Italia, përkatësisht 16 % dhe 14 % (Komisioni Evropian, EUROSTAT, 2012, pothuajse 75 % e sherbelës e importuar nga SHBA është me origjinë shqiptare. Kohët e fundit, një numër në rritje i kompanive më të vogla, të vendosura zakonisht në

Evropë, kanë filluar të blejnë nga eksportuesit shqiptarë.

Ka kërkesë në rritje nga blerësit ndërkombëtarë për bimët mjekësore dhe aromatike shqiptare. Gama e produkteve të kërkuara është rritur dhe aktorët e zinxhirit të vlerës së sektorit janë përgjigjur në përputhje me rrethanat. Tregjet e reja në Azi janë duke u eksploruar nga eksportuesit shqiptarë. Të dhënat tregtare konfirmojnë këtë prirje pozitive në eksporte (Tabela nr. 1.11). Vëllimet e tregtisë janë në rritje dhe vlera ka arritur në 50 milion EUR (EUROSTAT, 2020).

Tabela Nr. 1: Trendi i eksporteve të bimëve mjekësore dhe aromatike 2004–2020

Periudha	Vlera në (000/ EUR)	Sasia (tonë)
2004	11.250	7.022
2008	17.506	8.352
2009	14.125	4.599
2010	15.750	6.200
2011	19.109	7.170
2012	20.925	8.154
2013	19.939	9.330
2016	17.505	1.289
2017	26.555	11.875
2018	24.189	12,50
2019	29.873	11,71
2020	50.000	14.000

Burimi: UNSTAT

Tregu kryesor i eksporteve të bimëve mjekësore dhe aromatike shqiptare është Gjermania. Në vitin 2019, u eksportuan në Gjermani rreth 3.647 ton bimë mjekësore dhe aromatike që gjeneruan rreth 11,1 milion Euro. Kjo përfaqëson 33,5 % të të ardhurave totale të gjeneruara nga eksporti i bimëve mjekësore dhe aromatike. SHBA është tregun i dytë më i madh për bimë mjekësore dhe aromatike shqiptare; në vitin 2019 janë eksportuar në USA 2.656 ton bimë mjekësore dhe aromatike me vlerën prej rreth 8,8 milion Euro, që përfaqësojnë 26,5 % të të ardhurave të përgjithshme nga eksporti. UNSTAT Comtrade, 2019, EUROSTAT, 2020

Tabela Nr. : Vendet ku janë eksportuar bimët mjekësore dhe aromatike për vitin 2019

Vendi partner	Sasia (Ton)	Vlera (000 Euro)
Gjermani	3.647,6	11.156,1
ShBA	2.656,4	8.828,8
Turqi	1.059,9	2.273,1
Francë	549,3	1.784,0
Maqedonia e Veriut	496,8	889,5
Itali	342,0	865,2
Poloni	301,5	698,8
Spanjë	251,2	626,5
Austri	131,0	610,2
Kroaci	228,7	590,7
Bullgari	227,7	567,1
Kosovë	89,5	545,3
Greqi	215,6	538,6
Egjipt	207,2	431,4
Republika Çeke	183,5	351,8
Serbi	156,4	296,2
Hungari	154,2	286,9
Australi	74,7	272,0
Kanada	43,0	253,9
Mbretëri e Bashkuar	53,4	206,4
Sllovaki	267,0	205,5
Vende të tjerë	334,6	1.050,1
Shuma	11.671,2	33.328

Burimi: Eurostat

Shqipëria është nga eksportuesit kryesor ndërkombëtar për disa produkte, të tilla si sherbela, timusi, rigoni dhe trumza. Në disa tregje specifike, dhe në segmente të tregut, produktet shqiptare janë udhëheqëse të tregut, të tilla, në rastin e sherbelës në SHBA dhe të trumzës së egër në Gjermani. Bimët mjekësore dhe aromatike gjenden në të gjithë vendin, por grumbullimi është më i organizuar në disa rrethe si: Malësia e Madhe, Shkodër, Skrapar, Elbasan, Korçë, Berat, Përmet dhe Durrës. Gjatë 10 viteve të fundit, sektori është rritur në madhësi dhe në efikasitet.

Një numër në rritje i operatorëve fituan përvojën, kontaktet dhe burimet për të eksportuar direkt bimë mjekësore dhe aromatike.

Aktualisht, vlerësohet se jo më pak se 10 kompani kanë xhiro më të vogël se 1 milion Euro.

Bimët mjekësore dhe aromatike janë burim i rëndësishëm për gjenerimin e të ardhurave për popullsinë që jeton në zonat rurale.

Vend të rëndësishëm në analizë zë ajo e përfitimeve ekonomike që vijnë nga kultivimi i sherbelës, i makthit, i lavandulës dhe i bimëve të tjera mjekësore dhe aromatike.

3. Aktoret e Zinxhirit të Vlerës së MAPs në Shqipëri

3.1 Kultivuesit dhe mbledhësit

Sipas studimeve të mëparshme, janë deri në 100.000 persona që marrin të ardhura direkt ose indirekt nga sektori i bimëve mjekësore dhe aromatike; rreth 20.000 familje janë të angazhuara në mbledhjen e bimëve mjekësore dhe aromatike dhe rreth 5.000 në kultivimin e tyre. Nuk ka të dhëna të besueshme në lidhje me numrin aktual të mbledhësve apo të kultivuesve të bimëve mjekësore dhe aromatike. Megjithatë, të dhënat cilësore të siguruara nëpërmjet intervistave me aktorët kryesorë të sektorit sugjerojnë se numri i fermerëve të angazhuar në kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike është në rritje, ndërkohë që numri i atyre që merren me mbledhjen, të paktën në disa zona, po pakësohet.

Zakonisht, mbledhësit e bimëve mjekësore dhe aromatike jetojnë në zonat malore të vendit, ndërsa ata që merren me kultivimin e tyre, ndodhen në rajone kodrinore ose fushore (në disa raste edhe në zonat malore).

3.1.1 Mbledhësit e bimëve mjekësore dhe aromatike

Pjesa më e madhe e prodhimit primar të sektorit sigurohet ende nga mbledhja e bimëve mjekësore dhe aromatike të egra, edhe pse pjesa e bimëve mjekësore dhe aromatike të kultivuara po rritet me shpejtësi. Mbledhësit e bimëve mjekësore dhe aromatike mund të gjenden në të

gjithë vendin. Sa më e largët dhe rurale të jetë zona, aq më i lartë është përqendrimi i individëve dhe i familjeve që angazhohen në mbledhjen e bimëve mjekësore dhe aromatike të egra.

Mbledhja e bimëve mjekësore dhe aromatike është aktivitet sezonal me kohë të pjesshme, që bëhet kryesisht nga komunitetet që merren me pemëtarinë dhe me blegtorinë, burimet kryesore të të ardhurave të të cilëve përgjithësisht konsistojnë në mbarështimin në shkallë të vogël (kryesisht, mbarështimin e ripërtypësve të vegjël), mbledhja e bimëve mjekësore dhe aromatike si dhe të produkteve të tjera pyjorë jo-drunorë (NTFP)¹, veçanërisht arrat dhe gështenjat.

Në mënyrë tipike, një familje rurale, aktiviteti kryesor i së cilës është mbarështimi tradicional i ripërtypësve të vegjël, i sjell kopetë në kullotat e afërta ose në ato alpine që nga prilli e tutje dhe, ndërsa kujdeset për tufën, mbledh edhe bimë mjekësore dhe aromatike të egra brenda dhe rreth zonës së caktuar të kullotës. Këto bimë mjekësore dhe aromatike u shiten pa trajtim të mëtejshëm grumbulluesve vendas.

3.1.2 Kultivuesit e bimëve mjekësore dhe aromatike

Kultivimi i bimëve mjekësore dhe aromatike është i përqendruar në Diber por po zgjerohet me ritme të shpejta Tabela 1.1 më poshtë tregon disa të dhëna të pjesshme për numrin e kultivuesve në Diber sipas njësive Administrative.

Tabela Nr. 3: Numri i kultivuesve në sipas njësive administrative

Kategorizimi sipas sipërfaqes së kultivuar	Numri i fermave sipas zonave		
	Njesite Administrative	Njesite Administrative	Njesite Administrative
Deri 0,1 ha			-
0,1–0,50 ha			
0,51–1,00 ha			
1,01–2,00 ha			
Shuma			

Intervistat me aktorët kryesorë tregojnë rritje të interesit për kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike në pjesë të vendit ku një aktivitet i tillë ishte, deri më tani, mjaft i vogël. Në veçanti, ka një grup fermerësh (rreth 20) në rajonin e Dibrës që kultivojnë kokoçelin ngjyrë qielli (*Centaurea cyanus* L.) dhe aguliçen e vërtetë (*Primula veris* L.).

¹ Janë ushqime, substanca, materiale dhe/ose mallra të dobishme të marra nga pyje por që nuk përbëhen nga druri.

3.2. Produktet kryesore te bimeve aromatike dhe mjekesore

Produktet kryesore dhe llojet e produktit, karakteristikat e bimëve mjekësore dhe aromatike të egra janë të pranishme në të gjithë territorin e vendit, ku sherbela dhe erëza janë më të bollshme në veri, rigoni dhe trumza vijnë kryesisht nga Shqipëria Jugore-Qendrore, Çaji i Malit (*Sideritis raeseri*) nga qarku i Korçës dhe i Gjirokastrës.

Fermerët dhe mbledhësit shqiptarë të bimëve mjekësore dhe aromatike kultivojnë dhe mbledhin produkte të ndryshme, duke përfshirë lule, gjethe, fruta, barishte, lëvore dhe rrënjë. Vetëm një përqindje e vogël e rreth 200 varieteteve të llojeve kryesore të produkteve të eksportuara kultivohen, ndërkohë që vëllimi i përgjithshëm i bimëve mjekësore dhe aromatike të kultivuara është në rritje.

Mbledhja dhe kultivimi i bimëve mjekësore dhe aromatike për prodhimin e vajrave esencialë është rritur ndjeshëm vitet e fundit. Gjethet e dafinës, sherbela dhe kokrrat e dëllinjës janë bimë mjekësore dhe aromatike kryesore nga të cilat nxirret vaji esencial.

Tabela Nr. 4: Bimët mjekësore dhe aromatike kryesore që përdoren për prodhim vaji esencial

Nr.	Emri shqip	Emri latinisht	Të egra (Ë) Kultivuar (C) Të dyja (B)
1	Lavandula	<i>Oleum Lavandula angustifolia</i>	C
2	Makthi (Helikrisum)	<i>Oleum Helichrysum</i>	C
3	Sherbela	<i>Folia Salvia officinalis</i>	B
4	Rozmarina	<i>Folia Rosmarinus officinalis</i>	C
5	Timusi	<i>Folia Thymus vulgaris</i>	B
6	Rigoni i zakonshëm	<i>Folia Origanum vulgare</i>	C
7	Dafina	<i>Folia Laurus nobilis</i>	C
8	Barpezmimijëfletësh	<i>Achillea millefolium</i>	Ë
9	Dëllinjë e zezë	<i>Fructus Juniperus communis</i>	Ë

Burimi: Sondazh në terren

Produkti kryesor për biznesin e sektorit të bimëve mjekësore dhe aromatike është sherebela (*Salvia officinalis*) (USAID, 2010), me prurje të vlerësuar prej 2.500 deri në 3.000 ton në vit, duke përfshirë produktin e egër dhe atë të kultivuar. Sherbela është artikulli kryesor i eksportit të bimëve mjekësore dhe aromatike në SHBA. Kjo bimë mjekësore dhe aromatike mbledhet në gjendje të egër dhe të kultivuar. Në veçanti, sherebela deri tani është bima mjekësore dhe aromatike më e kultivuar. Kultivimi i disa bimëve mjekësore dhe aromatike të tjera është në rritje

të ndjeshme (p.sh. lavandula, trumza), por sherbela pritet të mbetet bima mjekësore dhe aromatike kryesore e kultivuar në vitet e ardhshme.

Gjethet e bimëve të tjera të rëndësishme mjekësore dhe aromatike si trumza, rozmarina, rigoni, mullanjadhja mjekësore dhe bari i bletës po kultivohen edhe në rajone të ndryshme të vendit për shkak të kërkesës së konsiderueshme në tregjet e huaja, përveç grumbullimit në natyrë. Ndër bimët mjekësore dhe aromatike të egra të përdorura për gjethet e tyre, shtërmëni (satureja) është një nga produktet kryesore të eksportuara.

Çaji i Malit përfaqëson nga produktet më të rëndësishme ndër *lulet*. Kultivohet dhe mbledhet në natyrë në viset jugore dhe juglindore të vendit. Megjithatë, kultivimi i çajit të malit (*Sideritis*) nuk ka qenë shumë i suksesshëm. Kultivimi ka ecur më mirë në zonat malore pranë Prespës dhe të Gjirokastrës. Produkte të tjera të kultivuara, që vlejnë për tu përmendur, janë mëllaga e zakonshme dhe kokoçelin ngjyrë qielli. Trend i vlefshëm i kohëve të fundit në zonat e Ersekës dhe të Dibrës është kultivimi i aguliçes së vërtetë. Intervistat me përfaqësues të agjencive shtetërore dhe me fermerët tregojnë se kjo bimë mjekësore është fitimprurëse, në krahasim me disa kultura të tjera më të zakonshme, veçanërisht në zonat me tokë joproduktive.

Ndër *frutat* e eksportuara vlen të përmendet molla e egër, dëllinja e zakonshme dhe e kuqe dhe boronica. Në vitin 2020 kërkesa për dëllinjë u rrit ndjeshëm, duke nxitur konkurrencë të ashpër midis kompanive eksportuese shqiptare. Për rrjedhojë, çmimet janë rritur ndjeshëm. Në mënyrë të ngjashme, çmimet e boronicës u rritën në vitin 2020 për shkak të prodhimit të ulët. Disa eksportues shqiptarë humbën para pasi çmimet e kontraktuara me blerësit e huaj ishin më të ulëta se çmimet aktuale të tregut vendas

Disa nga bimët mjekësore dhe aromatike mbledhen për rrënjët e tyre përveç gjetheve të tyre (p.sh., aguliçja e vërtetë, kokoçeli ngjyrë qielli). Megjithatë, kjo ndodh vetëm për bimët mjekësore dhe aromatike të egra. Për rrjedhojë, në disa zona, këto bimë mjekësore dhe aromatike po mbledhen së tepërmi.

Cilësia e produktit.- Disa nga bimët mjekësore dhe aromatike kryesore, të kultivuara ose të mbledhura dhe të përpunuara në Shqipëri, kanë pikë specifike të fuqisë në krahasim me bimët mjekësore dhe aromatike të prodhuara në shumicën e vendeve të tjera të Mesdheut, si sasia më e madhe e vajit esencial (p.sh. sherbela dhe makthi) ose cilësi më e mirë (p.sh., *Origanum vulgare*,

i ashtuquajturi “rigon i bardhë” dhe trumza) Përveç kësaj, disa bimë mjekësore dhe aromatike të kultivuara duket se kanë cilësi të shkëlqyer për shkak të kushteve klimatike dhe të përbërjes së tokës.

Pavarësisht nga përparësitë e përmendura më sipër, niveli i cilësisë së produktit përfundimtar varet nga shumë faktorë. Së pari, cilësia ndikohet nga praktikat e mbledhjes. Shpesh, disa nga bimët mjekësore dhe aromatike mbledhen para maturimit, gjë që çon në cilësi të ulët dhe në përqendrim të ulët të vajrave esencialë (p.sh., murrizi dhe dëllinja).

Së dyti, cilësia varet dhe nga lloji i proceseve pas mbledhjes, të adoptuara nga fermerët, si dhe nga kushtet e ruajtjes. Zakonisht, produktet thahen në fushë, gjë që çon në humbje të cilësisë dhe në ndotje bakteriale. Magazinat ose objektet e vogla të tharjes si sera përdoren rrallë. Në raste të tilla, cilësia është shumë më e lartë. Pas këtij procesi të parë të grumbullimit, sasi të shumicë transportohen tek konsoliduesi i madh lokal ose në kompaninë e përpunimit. Kushtet e magazinimit në ambientet e konsoliduesve të mëdhenj dhe të përpunuesve janë përgjithësisht shumë më të mira.

Çmimet. - Çmimet e bimëve mjekësore dhe aromatike varen nga dinamika e tregut të huaj. Prodhimi i pakët në disa vende konkurruese (p.sh. Bullgaria, Egjipti, Bosnja) ose kërkesa më e lartë për disa produkte, përkthehet në çmime më të larta për bimëve mjekësore dhe aromatike të prodhuara ose të mbledhura në Shqipëri. Por, çmimet mund të përcaktohen edhe nga dinamika e tregut vendas. Oferta e tepërt për disa produkte dhe prodhimi i ulët mund të ndikojnë në çmimet në nivel ferme.

Tabela e mëposhtme jep një përmbledhje të çmimeve aktuale në nivel ferme për disa produkte thelbësore. Ai tregon çmimet e disa bimëve mjekësore dhe aromatike të kultivuara ose të mbledhura në natyrë, çmimet (zakonisht janë për produktet e thata), prirjet e çmimeve dhe nëse, përgjithësisht, produkti shitet si organik apo konvencional.

Këto shifra bazohen kryesisht në intervista me fermerë, me kompani përpunuese dhe me ekspertë të sektorit.

Tabela nr.5 : Çmimet në nivel ferme

Emri shqip	Emri latinisht	Çmimi (lekë/kg)	Prirjet e çmimit	Konvencional ose organik
------------	----------------	--------------------	---------------------	-----------------------------

Aguliçe	<i>Primula veris</i>	3.000	Në rritje	Organik
Bari i bletës	<i>Melissa officinalis</i>	140	Stabël	Organik
Borziloku	<i>Ocimum basilicum</i>	140–150	Stabël	Konvencional
Çaj Mali	<i>Sideritis raeseri</i>	140–150	Në ulje	Konvencional
Kokoçel i kaltër	<i>Centaurea cyanus</i>	380	Në ulje	Konvencional
Dafina	<i>Laurus nobilis</i>	40	Stabël	Konvencional
Lavandula	<i>Lavandula angustifolia</i>	240	Stabël	Konvencional
Makthi (Akësi)	<i>Helichrysum italicum</i>	110–115	Në ulje	Konvencional
Rigon i zakonshëm	<i>Origanum vulgare</i>	200–220	Stabël	Organik
Rozmarina	<i>Rosmarinus officinalis</i>	130	Stabël	Organik
Sherbela	<i>Salvia officinalis</i>	120–140	Në rritje	Organik
Timusi	<i>Thymus vulgaris</i>	200	Stabël	Organik
Kalendula mjekësore	<i>Calendula officinalis</i>	350	Në rritje	Organik
Molla e egër	<i>Malus sylvestris</i>	135	Në rritje	Organik
Dëllinja e zezë	<i>Juniperus communis</i>	400	Në rritje	organik
Trëndafil i egër	<i>Rosa canina</i>	200	Në rritje	organik

Burimi: Sondazh në terren

Çmimet për bimët mjekësore dhe aromatike të rëndësishme, si sherbela, janë stabilizuar pas një rënije të mprehtë rreth shtatë vjet më parë. Sot sherbela tregtohet me 120–140 lekë, krahasuar me 60 lekë disa vite më parë. Edhe pse ka shpjegime të ndryshme për rënie të tillë të çmimit, më i akredituari lidhet me mbi-ofertën. Sot, prodhimi, veçanërisht i sherbelës së kultivuar, është stabilizuar. Si rezultat, dhe çmimet aktuale u stabilizuan. Çmimet e tjera të bimëve mjekësore dhe aromatike, si makthi, janë ndikuar negativisht edhe nga një goditje e ofertës. Në të kundërt, disa fruta, si boronica dhe dëllinja, u shitën me çmime më të larta në vitin 2020 për shkak të ofertës dhe të dinamikës së ofertës ndërkombëtare dhe të kërkesës së brendshme më të lartë për prodhimin e vajit esencial.

Rendimentet e bimëve mjekësore dhe aromatike të kultivuara, në varësi të tokës që kultivohen bimët mjekësore dhe aromatike, ndryshojnë nga rajoni në rajon. Përveç kësaj, fermat e mëdha priren të kenë rendimente më të lartë në krahasim me fermat e vogla.

Tabela jep informacion të detajuar mbi rendimentet minimale dhe maksimale për disa bimë mjekësore dhe aromatike të kultivuara në Shqipëri.

Tabela Nr.6: Rendimentet për ha të bimëve mjekësore dhe aromatike.

Emri shqip	Emri latinisht	Rendimenti minimal për dynym (kg)	Rendimenti maksimal për dynym (kg)
Lavandula	<i>Lavandula angustifolia</i>	100	180
Rigoni i zakonshëm	<i>Origanum vulgare</i>	200	300
Sherbela	<i>Salvia officinalis</i>	200	350
Timus	<i>Thymus vulgaris</i>	180	300

Burimi: Intervista me ekspertë dhe fermerë

Marzhi bruto. Të ardhurat bruto nga bimët mjekësore dhe aromatike ndryshojnë ndërmjet rajoneve dhe varieteteve të bimëve mjekësore dhe aromatike të kultivuara. Për shembull, marzhe bruto për kokoçelin bojë qielli shënojnë rreth 10 % për shkak të çmimeve të ulëta, ndërsa ato të aguliçes janë shumë më të larta (vlerësohet rreth 50%) meqenëse çmimet janë rritur në mënyrë të qëndrueshme gjatë vitit të kaluar (çmimi aktual në nivel ferme është 3.000 deri në 3.100 lekë).

Konkurrueshmëria. Intervistat me fermerë dhe aktorë të tjerë relevantë tregojnë se faktori kryesor që kontribuon në konkurrencën e sektorit në nivel ferme është kostoja e ulët e punës dhe faktorë të tjerë të ndryshëm që lidhen me klimën dhe me përbërjen e tokës. Për kultivuesin e bimëve mjekësore dhe aromatike, madhësia e vogël e fermës dhe mungesa e mekanizimit përfaqësojnë pengesat kryesore për t'u bërë konkurrues. Fermat ekstensive dhe të specializuara duket se janë shumë më produktive dhe konkurruese. Megjithatë, rritja e kostove të punës po ndikon edhe në konkurrencën e fermave të mëdha.

Për mbledhësit e bimëve mjekësore dhe aromatike, qasja e lehtë në vëllime të mëdha të bimëve mjekësore dhe aromatike të egra mbetet faktori kryesor kontribues që siguron të ardhura të arsyeshme. Mbledhja e bimëve mjekësore dhe aromatike të egra është ende aktivitet i zbatueshëm vetëm për individët që jetojnë në zona të thella dhe të pazhvilluara të pasura me bimë mjekësore dhe aromatike të egra.

Tabela Nr. : Aktorët e zinxhirit të vlerës së bimëve mjekësore dhe aromatike (MAPs)

N o.	Company	Location / Address	Contact person	Contact phone	Contact e-mail	Main products	Annual output	Own production area (ha)	Valid standards	website
1	Albanian Herb	14 Neighbourhood, Durres, Albania	Kujtm Zere/lira Zere	0692092257/0684572023	info@albanian-herb.com	Origanum vulgare	100-2000 ton	400 ha	Rain Forest Alliance NOP Certification Organic Certification	https://albanian-herb.com/
						Salvia officinalis	500-1000 ton			
						Satureja montana	200-1000 ton			
						Rosmarina officinalis	300-1000 ton			
						Thymus vulgaris	100-800 ton			
2	Mucaj Herbs Shpk	Bajze, Koplik	Vasel Mucaj	0674000020/+355(0)67 202 0592	info@mucajherbs.com	Salvia officinalis	100-2000 ton	1000 ha	ISO 22000 Kosher Certification Organic Certific	https://www.mucajherbs.com/
						Lavandula	500-100			

						angusti folia	0 ton		ation USDA Nationa l Organic Progra m Regulati on 7 CFR part. 205	
						esentia l oils				
3	Natural ba	Ishem, Durrës	Sokol Proja	684863223	info.naturalalba@gmail.com	Organum vulgare		60 ha	Organic Certific ation	http://www.naturalalba.com/
						Juniper us commu nis				
						Salvia officina lis				
4	Bidaj Shpk	BIDAJ SH.P.K. Bishti i Zhurit, Autostrada Rrogozhine 2503 Rrogozhine	Luis Bidaj	692600320	info@bidaj.al	Juniper us commu nis		NA	Organic Certific ation	https://bidaj.al/
						Rubus ulimifol ius				
						Saturej a				

						monta na				
						Centau rea cyanus				
5	Gjedra Shpk	Lagjia Barrikade, Rruge Ushqimore , Berat	Anisa Qose	682091147	info@gjedra.al	Salvia officina lis		NA	Kosher Certific ation ISO 9001 USDA Certific ation HACPP Certific ation	http://gjedra.al/sq/
						Rubus ulimifol ius				
						Thymu s vulgaris				
						Lavand ula angusti folia				
						Malus sylvestr is				
6	Biobes	Sopez 53 Gradishtë, Divjakë, 9021, Albania	Besni k Koci	694045444	info@biobes.al	Centau rea cyanus		NA	Organic Certific ation US Organic Standar d NOP	https://www.biobes.al/en
						Calend ula officina lis				
						Heliant hus annus				
						Hyperic um				

						perfora tum				
						Hedera helix				
7	Albkalus tyan	Vlashaj Nr 101,Mami nas Durres	Xhevi t Hysen aj	692060915	info@albkalustyan.com	Salvia officina lis		NA	HACCP and HARPC systems	www.albkalustyan.com
						Juniper us commu nis				
						Juniper us oxyced rus				
						Thymu s vulgaris				
						Essenti al Oils				
8	Cibuku Shpk	Korce	Gjergj i Cibuk u	68 20 67 332	cibukugjergji@yahoo.com	Trifoliu m pratens e		NA	Organic Certific ation	https://www.cibuku.al/
						Primula veris				
						Juniper us commu nis				
						Centau rea cyanus				

9	Agro Herbal	Mamurras (ish NB grumbulli mi), LAC	Arif Daci	672064520	info@agroherbal.net	Sambucus nigra		NA	Organic certification	https://www.agroherbal.net/index.html
						Juniperus communis				
						Salvia officinalis				
						Centauria cyanus				
						Tilia grandiflora				
10	Filipi Shpk	Sanxhak, Kurbin	Filip Gjoka	68 2021352	info@filipicompany.com	Salvia officinalis		NA	Organic Certification	https://filipicompany.com/?lang=sq
						Lavandula angustifolia				
						Thymus vulgaris				
						Centauria cyanus				
						Essential Oils				

1 1	Herba Fructus	Ruga Herba Fructus, Elbasan 3016	Dritan Koldashi	69 204 8440	herbafruta@gmail.com	Salvia officinalis Tilia grandiflora Rubus ulimifolius Betula alba	NA	ISO 22000 ISO 9001 Kosher Certification HACPP	https://herbafructus.al/
1 2	Aronia	Shushice Elbasan	Marsida Ylli	688046064	info.aronia@gmail.com			Organic Certification	https://www.facebook.com/aroniaherbals/
1 3	Relikaj shpk	Ruga Kalldrunit, Koplik	Ramadan Likaj	696407216	o.likaj@relikaj.net	Salvia officinalis Lavandula angustifolia Helicrysum italicum	100	BRC Global Standard RainForest Alliance HACPP Kosher Certification USDA Organic	https://www.relikaj.net/index-2.html
1 4	MEIA Shpk	Mangull, Albania		682472823	petritskora@gmail.com	Helicrysum	NA	NA	https://www.meiaoils.com/

		Koplik, Albania	Emila nd Skora			italicu m ess.oils				
						Salvia officina lis ess.oils				
						Lauris Nobilis ess.oils				
1 5	Zagora Shpk	Rruga e Palvarit, Koplik 4301, Albania	Haxhi Berca	68 201 4113	NA	Salvia officina lis			NA	
						Thymu s vulgaris				
						Lavand ula angusti folia				
1 6	SunHer b	Tirane	Timo Heido rn	692094460	timo@sunherb.biz	Malva sylvestr ia			50	Organic Certific ation
						Calend ula officina lis				ttps://sunherb.biz

						Lavandula angustifolia				
17	ERBA ALBANIA	Malesia Madhe 4301,	Kujtim Keka	69 3616661	info@erba-albania.com	Salvia officinalis		50	Organic certification	https://www.erba-albania.com/
						Thymus vulgaris				
						Lavandula angustifolia				